

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së tretë - III-të, të rregullt të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 30.03.2020, ora 09:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Jetmir Berisha, Sabit Bullatovci, Sabri Rexhepi, Ali Zogjani, Durim Hajra, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Arjana Zogjani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Mensur Grajqevci, Hysni Hasani dhe Ljubisa Qirkoviq.

Mungon: Albert Jasharaj, Mirvete Gërguri, Miranda Shabani, Aida Alimi dhe Suhat Ademi.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave e Buxhetit dhe Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 29.01.2020.
2. Raporti vjetor i punës për funksionimin e Kuvendit të Komunës për vitin 2019
3. Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019.
4. Propozimi për shqyrtimin e raportit financiar për buxhetin e shpenzuar për vitin 2019.
5. Kërkesa e Shtabit Emërgjent të Komunës për lejimin e mjeteve financiare për parandalimin dhe përhapjen e Coronavirus-it, COVID - 19 në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe sqaroi se pikat dy, gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë e rendit të ditës: Pyetje dhe përgjigje parlamentare; Propozimi për marrjen e rekomandimeve lidhur me problemet e qytetarëve të Luginës të zhvendosur në Kosovë; Propozimi për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për palën Selatin Potera në fshatin Sllatinë e Madhe; Propozimi për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Rregullores për organizimin, bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës dhe të ndryshme largohen nga shqyrtimi në mbledhjen e sotme për arsye të rrethanave të njohura, meqë jemi në kohën e pandemisë së Coronavirus-it COVID - 19, ndërsa në shqyrtim do të jetë kërkesa e Shtabit Emërgjent të Komunës për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 250,000.00€ për parandalimin dhe përhapjen e Coronavirus-it, COVID - 19 në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës. Hap diskutimin.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës për mbledhjen e sotme, sipas sqarimeve të dhëna më lartë

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 29.01.2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim 'ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 29.01.2020', hap diskutimin për vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë nuk kam ndonjë vërejtje në përmbajtjen e ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 29.01.2020, por meqë nuk kemi publikim të audioinçizimeve të mbledhjeve ne votojmë 'kundër'. Pasi që vërejtje apo sugjerime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 29.01.2020'.

U votua me: trembëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën 29.01.2020'.

Pika e dytë (2) - Raporti vjetor i punës për funksionimin e Kuvendit të Komunës për vitin 2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Raportin vjetor të punës për funksionimin e Kuvendit të Komunës për vitin 2019', i cili në përmbajtjen e tij pasqyron të dhëna për punën e kryer dhe procesin e vendim-marrjes në Kuvendin e Komunës, për pyetje parlamentare në Kuvendin e Komunës janë dhënë përgjigje gojore. Hap diskutimin.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e konstatoi të mbyllur diskutimin për 'Raportin vjetor të punës për funksionimin e Kuvendit të Komunës për vitin 2019'.

Pika e tretë (3) - Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Raportin vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019', ky paraqiten të detajizuara, punët, aktivitetet dhe projektet e realizuara nga Drejtoritë e Komunës gjatë vitit 2019. Hap diskutimin.

Durim Hajra: Kur shqyrtohet raporti i punës, Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Komunës duhet të jenë prezentë, kjo praktikë e vendosur nga ana e Ekzekutivit të Komunës nuk është fare në rregull nga ana e tij, është duke u injoruar Kuvendit i Komunës, në fakt ne nuk kemi as për çka të diskutojmë në këto rrethana.

Migjen Kolshi: Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019, është e pa arsyeshme që të diskutohet dhe analizohet sot, nuk është asgjë urgjente, vetëm nëse ju dëshironi të kaloni pa debate konstruktive dhe thelbësore. Ne këtu i nderuari z. Nënkryetar i Komunës nuk jemi as në përputhje me rregullat e caktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës, jemi të rrezikuar, nuk i'a vlen të diskutojmë për raportin e punës njëvjeçare.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e konstatoi të mbyllur diskutimin për 'Raportin vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019'.

Pika e katërt (4) - Propozim për shqyrtimin e raportit financiar për buxhetin e shpenzuar për vitin 2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shqyrtimin e raportit financiar për buxhetin e shpenzuar për vitin 2019', ftoi Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Theksoi se raportit financiar për buxhetin e shpenzuar për vitin 2019', është përgatitur në përputhje me rregullat e thesarit, dhe ju për arsye të ditura tani, ju keni patur kohë të mjaftueshme për shqyrtimin dhe analizimin e shpenzimeve nëpër secilën Drejtori të Komunës, për kode ekonomike dhe programe e nën-programe. Në Administratën Komunale buxheti i alokuar për shpenzim është në shumën e mjeteve financiare prej: 7,536,725.05€, buxheti i shpenzuar është në shumë prej: 5,397,795.20€ dhe saldo e mbetur për shpenzim është në shumë prej: 1,005,500.45€; në Arsim buxheti i alokuar për shpenzim është në shumën e mjeteve financiare prej: 4,656,453.84€, buxheti i shpenzuar është në shumë prej: 4,320,871.40€ dhe saldo e mbetur për shpenzim është në shumë prej: 155,361.42€; në Shëndetësi buxheti i alokuar për shpenzim është në shumën e mjeteve financiare prej: 2,307,421.21€, buxheti i shpenzuar është në shumë prej: 1,893,339.18€ dhe saldo e mbetur për shpenzim është në shumë prej: 357,874.70€ dhe në Zyrën e Komuniteteve buxheti i alokuar për shpenzim është në shumën e mjeteve financiare prej: 33,299.02€, buxheti i shpenzuar është në shumë prej: 33,275.22€ dhe saldo e mbetur për shpenzim është në shumë prej: 6,823.84€. Në total buxheti i alokuar për vitin 2019, me mjetet financiare të bartura është në shumë të mjeteve financiare është në shumë prej 14,533,902.12€, buxheti i shpenzuar është 11,645,281.00€, ndërsa mjete financiare të lira janë 2,888,621.12€. Në përqindje buxheti është shpenzuar 80.12%. Buxheti i shpenzuar për kategoritë ekonomike në përqindje është si vijon: për paga dhe mëditje është 41.01%, për mallra e shërbime është 11.80%, për shpenzime komunalë është 2.36%, për subvencione dhe transfere është 5.35% dhe për investime kapitale është 39.48%. Të hyrat vetjake kanë qenë të planifikuara në shumë të mjeteve financiare prej: 2,439,993.00€, ndërsa janë realizuar shuma e mjeteve financiare prej: 3,360,542.56€, ose 37.72% mbi planifikimin.

Durim Hajra: Lidhur me raportin financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2019, kemi patur kohë të mjaftueshme që ta analizojmë, mirëpo shqyrtimi i tij po bëhet në rrethana jashtë normales. Ne i kemi vërejtjet tona për mos shpenzimin e buxhetit, ku 20% e buxhetit është i pa shpenzuar, kjo punë nuk është në rregull, shembull real është shëndetësia, ku për shëndetësinë është alokuar shuma e mjeteve financiare prej 2,400,000.00€, ndërsa janë shpenzuar vetëm 1,800,000.00€, kur nevojat për këtë sektor janë të mëdha, unë dyshoi në menaxhimin jo të mirë të buxhetit. Shuma e shpenzuar për shërbime kontraktuese tjera është 390,000.00€, për karburante të naftës 72,000.00€, për udhëtime jashtë vendit është shpenzuar shuma e mjeteve financiare prej 48,000.00€, për mirëmbajtjen e automjeteve është shpenzuar shuma prej 45,000.00€ dhe për dreka zyrtare është shpenzuar shuma prej 43,000.00€. Shpenzimet e tilla e arrin shumën 677,000.00€. Subvencionet e arrin shumën prej 1.1 milion euro, ku hyn edhe pagesa për përfituesit individual dhe pagesat për entitetet publike dhe jo publike, e tjera, këto janë shpenzime të larta jashtë normales, vetëm një drekë nga Qendra për Punë Sociale ka qenë 3,115.00€, dikun tjetër për drekë kjo shumë është 903.00€, ka edhe shumë shpenzime tjera vend e pa vend, andaj ne jemi kundër aprovimit të raportit financiar për buxhetin e shpenzuar në vitin 2019.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kjo pikë është dashur të shmanget nga rendi i ditës, meqë dihet arsye pse ne jemi këtu sot. Ne po injorohemi nga Ekzekutivi i Komunës, por ne jemi këtu për të punuar në interesin e qytetarëve, ne jemi të respektohet ligji, e jo të shqyrtohen sot raportet e punës dhe raporti financiar.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Buxheti i komunës është shpenzuar sipas standardeve dhe ligjeve, ne e bëjmë barazimin çdo muaj. Shpenzime individuale bëhen edhe në tjera shtete, ne ndajmë subvencione për fermerë, për studentë në arsim dhe në shëndetësi për pacientët të cilët kanë nevojë për shërim dhe terapi shëndetësore. Për shërbime kontraktuese tjera në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë shpenzuar 370,000.00€ për projektin e Karitas-it, për shpenzime të varrimit, për pagesën e qirasë së fotokopjeve e tjera.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë dua t'i them dy fjalë, ne këtu jemi për të marrë vendime për menaxhimin e situatës emergjente nga sëmundja ngjitëse COVID - 19 dhe miratimin e buxhetit për shpenzime në shëndetësi, e jo të shqyrtojmë këtu pesë apo gjashtë pika të rendit të ditës. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të shpenzuar për periudhën njëvjeçare është absurde të bëhet duke e keqë-përdorur kohën e pandemisë së virusit COVID – 19, as raportin e punës së Kryetarit të Komunës. Unë nuk do të flas tani për këto raporte, sepse kjo nuk është në rregull fare.

Migjen Kolshi: Ju nuk e keni shumicën tani, ne si opozitë mund ta lëshojmë mbledhjen, ju kërkoi që kjo pikë të hiqet nga shqyrtimi sot, sepse ju po e keqë-përdorni gjendjen e pandemisë. Ne jemi ardhur këtu sot të merremi vetëm me çështjen e pandemisë dhe marrjen e masave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të gjithë ishim dakort që të shqyrtohen këto pika të rendit të ditës.

Durim Hajra: Ne u pajtuam që të reduktohen pikat e rendit të ditës, unë kam ardhur sot këtu të marrim ndonjë vendim vetëm për marrjen e masave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve, tani ne e kemi një njoftim për shpenzim të 154,000.00€. Sot këtu nuk po respektohen as rregullat e vendosura, neve nuk na është matur as temperatura. Unë kam propozuar znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës që mbledhja e sotme e Kuvendit të Komunës të mbahet në sallën e sportit apo në shkollën e afërt këtu 'Daut Bogujevci', këtë propozim ua kam dërguar edhe juve.

Driton Ademi: E nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës ju e caktoni rendin e ditës, është dashur të konsultoheni, ju në rastin konkret jeni duke e testuar durimin tonë. Në rendin e ditës është dashur të vendoset vetëm kërkesa për miratimin e mjeteve financiare për situatën me pandeminë COVID - 19, ju po manipuloni.

Pasi që diskutime apo sqarime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Propozimin për aprovimin e raportit financiar për buxhetin e shpenzuar për vitin 2019'.

U votua me: njëmbëdhjetë vota 'për', dy 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për aprovimin e raportit financiar për buxhetin e shpenzuar për vitin 2019' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-dhjetor të vitit të 2020, në shumë të përgjithshme prej 11,645,281.00€.

2. Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
 - 2.1 Në administratën komunale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 5,397,795.20€;
 - 2.2 Në arsim, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 4,320,871.40€;
 - 2.3 Në shëndetësi dhe Qendrën për Punë Sociale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,893,339.18€;
 - 2.4 Në Zyrën e Komuniteteve, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 33,275.22€.

Pika e pestë (5) - Kërkesa e Shtabit Emërgjent të Komunës për lejimin e mjeteve financiare për parandalimin dhe përhapjen e Coronavirus-it, COVID - 19 në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim, 'Kërkesën e Shtabit Emërgjent të Komunës për lejimin e mjeteve financiare për parandalimin dhe përhapjen e Coronavirus-it, COVID - 19 në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', në shumë të mjeteve financiare prej 154,000.00€ sipas njoftimit, të cilës shumë propozohet t'i shtohet edhe shuma prej 250,000.00€. Ftoi Drejtorin e Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Lidhur me pandeminë shëndetësore COVID – 19, ne jemi duke vepruar sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik. Shtabi Emërgjent i Komunës ka ndërmarrë disa hapa për parandalimin e sëmundjes si vijon: vendimi për pastrimin dezinfektues për fshirjen-larjen e rrugëve dhe hapësirave publike në nivel komune në shumë prej: 45,000.00€; vendimi për dezinfektimin e objekteve kolektive banesore, hyrjeve/daljeve dhe objekteve afariste në shumë prej: 32,000.00€; vendimi për furnizim me pajisje dhe material mjekësorë për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve në shumë prej 50,000.00€; vendimi për furnizim me ushqim të thatë për stafin mjekësorë të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, Qendrës për Punë Sociale në shumë prej: 12,000.00€; vendimi për furnizim me pako ushqimore dhe mjete hixhenike për nevojat e qytetarëve me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale në shumë prej: 10,000.00€; vendimi për furnizim me miell për nevojat e qytetarëve me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale në shumë prej: 5,000.00€ dhe kontrata e nivelit qendror të furnizimit me bukë dhe Komuna bashkë me shtabin emërgjent, që ka paraparë shpërndarjen e 2000 bukëve për 700 familje kryesisht nga radhët e komuniteteve pakicë: romë, ashkalinj dhe egjiptian. Për këto çështje procedurat e prokurimit publik vazhdojnë pas alokimit të buxhetit për këtë vitë. Ne propozojmë që kësaj shume t'i shtohet edhe shuma e mjeteve financiare prej: 250,000.00€, që do të shpenzohen sipas nevojës. Ne kemi dërguar një kërkesë që Ministria e Financave dhe Transfereve të na ndanë shumën e mjeteve financiare prej: 400,000.00€. Ne e dimë që mund ta marrim edhe shumën e mjeteve financiare prej 5% të secilit projekt kapital, ne do të mundohemi që të mos i marrim këto mjete financiare në dëm të projekteve kapitale.

Ali Ismaili: Tani po kalojmë në temën kryesore lidhur me pandeminë botërore të Coronavirus-it COVID - 19, që e ka përfshirë mbarë botën, vendin tonë dhe Komunën e Fushë-Kosovës, njoftimi që na ka ardhur neve për lejimin e mjeteve financiare në fakt është i turpshëm, nuk përmbanë sqarime të mjaftueshme për hapat e ndërmarrë dhe hapat që do të ndërmerren në periudhën e ardhshme. Gjendja tani është e jashtëzakonshme si në kohë lufte, ku luftëtarët tani janë mjekët, ata janë në safin e parë të luftës kundër pandemisë, mjekët në Qendrën tonë shëndetësore, ndërsa në këtë mbledhje mungon Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Drejtori për Financa dhe

Buxhet lexoi hapat që do të ndërmerren lidhur me dezinfektimin, pajisjet shëndetësore, furnizimin me pako ushqimore, pako hixhenike, miell dhe bukë. Ne nuk kemi informata sa njerëz nga komuna jonë kanë hyrë në Aeroport dhe pikat tjera kufitare nga Italia që tani është vatër e përhapjes së pandemisë COVID - 19, sa persona janë të vetëizoluara?. Me bukë ka furnizime edhe në kohë lufte, nuk kemi hequr keq. Unë propozoi që në kuadër të shumës së mjeteve financiare që e ndajmë ne sot të stimulohen edhe punëtorët e Karitasit, mjekët dhe infermerët që janë duke e kryerë punën e tyre, punëtorët shëndetësorë duhet të jenë të barabartë, të mbrohet dinjiteti i tyre tani. Të ndahet një shumë për këta mjekë dhe infermere prej së paku 100.00€ apo 200.00€. Sot duhet të jemi vigjilent, t'i përkrahim punëtorët shëndetësorë, sepse edhe me para nuk mund të trajtoheni në institucione shëndetësore brenda apo jashtë vendit nëse keni nevojë, nuk keni ku të shkoni, pavarësisht kostos financiare dhe mundësive buxhetore. Mjekët e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, duhet të stimulohen në bazë të performancës së tyre. Unë e kam dhënë më herët qëndrimin tim lidhur me punëtorët e projektit të Karitasit, për këtë herë do të veqoi qëndrimin tim, sepse këta punëtorë duhet të stimulohen.

Nënkryetari i Komunës: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Ne duhet të shpresojmë që kjo pandemi botërore të kalon edhe në vendin tonë, të punojmë për mbrojtjen e familjeve tona, secili duhet t'i respektojë rregullat e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik. Lidhur me punëtorët shëndetësorë që punojnë tani në kuadër të projektit të Karitasit, duhet ta gjejmë një mënyrë për kompensimin e tyre, ky kompensim ju takon. Shuma prej 250,000.00€ duhet t'i shtohet shumës prej 154,000.00€, është në funksion të marrjes së masave parandaluese për përhapjen e Coronavirus-it COVID – 19. Sa kemi informata ne dyshohet për tre persona në fshatin Miradi e Epërme, këta persona janë nën vëzhgim. Mjekët dhe policia janë duke e kryerë punën e tyre, lidhur me aspektin shëndetësorë unë as nuk dua të flas kur këtu i kemi mjekët Remziun dhe Dritonin, që kanë lexuar literaturë shëndetësore për sëmundjet ngjitëse. Por ne duhet të jemi në kontakt me njerëzit, fermerët duhet t'i kryejnë punët e tyre pranverore nëpër arat e tyre, njerëzit duhet të furnizohen me gjëra ushqimore e tjera. Shuma e cekur prej 250,000.00€ i nevojitet Shtabit Emërgjent për menaxhimin e situatës.

Remzi Shala: Në ditët e sotme punëtorët shëndetësorë dhe policia janë ushtarët sot në frontin e luftës. Ne duhet t'iu besojmë rekomandimeve të dhëna nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe institucioneve. Për menaxhimin e situatës emërgjente shëndetësore, komuna jonë ka formuar Shtabin Emërgjent të Komunës, për arsye të specifikave të komunës tonë jemi frikësuar, por shqyr prej Zotit deri tani nuk e kemi asnjë rast të konfirmuar me COVID - 19, urojmë që të kalojmë me pasoja minimale. Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, ka filluar me marrjen e masave parandaluese, një ekip mjekësorë nga komuna jonë qëndron në Aeroportin Ndërkombëtar 'Adem Jashari' për të verifikuar të ardhurit nga shteti i Italisë. Qeveria e Kosovës na ka furnizuar me një sasi të vogël të uniformave dhe materialit tjetër shëndetësorë. Mangësitë në punën tonë do të shiheshin po të mos ishin punëtorët shëndetësorë nga projekti i Karitasit, të cilët duhet të stimulohen për punën e tyre, sepse janë në ballë të frontit, andaj duhet të përkrahen. Materialet shëndetësore që blihen të jenë cilësore, neve na kanë ardhur disa mantila jo të mira, ne duhet të mos u hymë në hak këtyre punëtorëve, të cilët mund të infektohen gjatë punës së tyre. Unë i bashkëngjitem thirrjes së anëtarit të Kuvendit të Komunës z. Ali Ismaili që punëtorët shëndetësorë në kuadër të projektit të Karitasit të stimulohen dhe përkrahen.

Driton Ademi: Ne duhet të jemi të lumtur që deri tani asnjë person nga Komuna e Fushë-Kosovës nuk është i infektuar, por periudha e inkubacionit është katër javë, simptomat e sëmundjes në

shumicën e rasteve nuk vërehen. Komuna jonë e ka bërë një menaxhim 'ad hoc', të situatës emergjente shëndetësore. Duhet ta kemi një menaxhim të planifikuar që në varësi të situatës të bëhet pastrimi dhe dezinfektimi i zonave të caktuara, edhe nëpër fshatra. Personalisht unë jam për dy koncepte, së pari struktura operacionale të kryen punët e veta dhe së dyti të mos merren veprime kundërligjore që bien ndesh me ligjin në kohën e pandemisë. Në strukturën operacionale të veprimeve bënë pjesë edhe policia që është në çdo kënd, në shëndetësi të gjithë janë të mobilizuar, duhet të përcjellen edhe veprimet nga sektori privat. Në krijimin e Shtabit Emergjent të Komunës, Kryetari i Komunës e ka injoruar Kuvendin e Komunës si organ kryesorë përfaqësues dhe vendim-marrës, sot ne edhe përmes email adresave tona duhet të njoftohemi për situatën emergjente shëndetësore. Duhet të përkrahen të gjitha rastet nga skema sociale, po ashtu duhet të fillohet të mendohet edhe për situatën ekonomike pas pandemisë, të planifikohet organizimi dhe fazat e zbatimit. Për këto punë e keni edhe ndihmën e rinisë së Nismës Socialdemokrate në shpërndarjen e ndihmave, varësisht prej rrjedhës së situatës. Në kohën e Perandorisë Osmane kur ka patur pandemisë popullata ka kaluar në kodra të larta nën kujdesin e ushtrisë. Po ashtu duhet të punojmë edhe për identifikimin e donatorëve të mundshëm, duhet të përcjellim me kujdes edhe veprimet dhe masat që marrin shtetet tjera.

Migjen Kolshi: Shumë shpjegime për pandeminë u dhanë nga parafolësitë e mi anëtarët e Kuvendit të Komunës: Dritoni, Remziu dhe Aliu. Ne nuk e dime kush janë anëtarët e Shtabit Emergjent të Komunës, si funksionon grupi i juaj, si po zbatohen procedurat e prokurimit, të mos bëhen shkelje në këtë kohë kur qytetarët kanë nevojë për ndihmën e shtetit, respektivisht komunës. Shuma e mjeteve financiare prej 250,000.00€ duhet të shkon në vendin e duhur, të mos keqë-përdoret. Të dihet ky po deponohen pajisjet dhe mallërat, të pranohen nga një Komision adekuat shëndetësorë. Për këtë arsye ne po kërkojmë që në Shtabin Emergjent të Komunës, të kemi edhe anëtarë të Kuvendit të Komunës nga opozita.

Nënkryetari i Komunës: Lidhur me situatën e krijuar nuk duhet të krijohen teori konspirative, se mjetet financiare që ndahen për menaxhimin e pandemisë do të keqë-përdoren. Sqaroi se materiali sanitar pranohet nga mjekët, njësoi veprohet edhe me materialin për dezinfektim. Procedurat zbatohen sipas rregullave të caktuara nga Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik. Anëtare e Shtabit Emergjent të Komunës është edhe znj. Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës.

Migjen Kolshi: Unë po frikësohem se këto mjete financiare do të keqë-përdoren, andaj po kërkoj që të jeni më vigjilentë në këtë situatë të rëndë për qytetarët.

Driton Ademi: Disa pika këtu kanë mundur edhe të deshifrohen dhe bashkohen siç është pika një dhe dy për dezinfektimin e hapësirave publike dhe hyrje/daljen e ndërtesave kolektive, si dhe pikat pesë dhe gjashtë blerja e pakove ushqimore e higjienike dhe mielli.

Sabit Bullatovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne e dime se epidemia shkatërron, unë i kam dy vajza në sektorin e shëndetësisë, në fshatin Miradi e Poshtme Qendra e Mjekësisë Familjare është e mbyllur, pyes pse po ndodh kjo, banorët kanë nevojë për shërbime shëndetësore. Furnizimi me pajisje mbrojtëse për personelin shëndetësorë nuk është bërë. Janë mbi pesë mijë mjekë në tërë Kosovën nuk është punuar sa duhet për ta, mungojnë kushtet për punë, tani ata janë të rrezikuar dhe duhet ta kryejnë punën e tyre për mbrojtjen e popullatës tonë.

Ilir Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kjo kërkesë për mjetet e kërkuara financiare duhet të aprovohet, pjesa tjetër e shpërndarjes dhe çështjeve tjera kryehn nga profesionistët nën mbikëqyrjen e Shtabit Emergjent të Komunës.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Është mirë që të gjithë të jemi të angazhuar në përgjigjëjen ndaj kësaj sfide, tani jemi në kohë të pandemisë, duhet t'i zgjedhim ngjarjet, që të kemi një zhvillim të mirë në vendin tonë. Ne tani kemi një mungesë totale të informimit nga Shtabi Emërgjent i Komunës si anëtarë të Kuvendit të Komunës, ne nuk kemi tjetër mjet të informacionit përveç ueb-faqës së komunës. Komuna jonë është mjaft heterogjene, me banorë nga vise të ndryshme të Kosovës, duhet të identifikohen njerëzit, të dihen kah janë, sepse ka raste edhe kur simptomat e sëmundjes nuk vërehen fare. Ne jemi një komunë e pasur me tejkalim të buxhetit, duhet ta kemi një menaxhim të mirë të njerëzve, po ashtu të fillojmë të merremi edhe me aspektin ekonomik, sepse bizneset janë të dëmtuara, kanë nevojë të përkrahen. Është e rëndësishme që shtabi edhe ne si pozitë dhe opozitë të jemi të gjithë bashkë, shpenzimet tani duhet të rriten, të rritet qarkullimi ekonomik. Arsimi po zhvillohet përmes internetit, duhet të përcjellen mësimdhënësit dhe nxënësit edhe nga komuna, bizneset duhet të përkrahen të mos ndihen të vetmuara, por ta ndjejnë intervenimin e shtetit. Po ashtu nuk duhet të jemi shumë euforik se kjo krizë do të kalon shpejtë. Banorët nga lagjet e komuniteteve janë ankuar shumë, duhet të shikohen hallet e tyre. Unë pajtohem me mendimin e parafolësve, Dritonit dhe Aliut, se ne jemi në funksion të ndihmës dhe përkrahjes për shtabin emërgjentë dhe qytetarët e komunës, të cilëve i'u urojmë shëndet dhe kërkojmë nga ata, që në këtë kohë të qëndrojnë në shtëpitë e tyre.

Ali Ismaili: Kërkojmë që Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të marrë masa që qendrat shëndetësore të jenë funksionale, t'i ofrohet ndihma e nevojshme pacientëve edhe në fshatra. Ne nuk e kemi një përshkrim të saktë në material, se si do të shpenzohet shuma e mjeteve financiare prej: 250,000.00€. Një mjek mund t'i ketë edhe dyqind kontrolla, andaj edhe njëherë por kërkoi që mjekët dhe infermerët nga projekti i Karitasit të përkrahen.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim: Kërkesën e Shtabit Emërgjent të Komunës për lejimin e mjeteve financiare për parandalimin dhe përhapjen e Coronavirus-it, COVID - 19 në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në shumë të mjeteve financiare prej 154,000.00€ sipas njoftimit, të cilës shumë propozohet t'i shtohet edhe shuma prej 250,000.00€, ku duhet të përfshihet edhe mundësia e përkrahjes së punëtorëve shëndetësorë të punësuar në projektin e Karitasit.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e dy anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet të votave e aprovoi: Kërkesën e Shtabit Emërgjent të Komunës për lejimin e mjeteve financiare për parandalimin dhe përhapjen e Coronavirus-it, COVID - 19 në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në shumë të mjeteve financiare prej 154,000.00€ sipas njoftimit, të cilës shumë propozohet t'i shtohet edhe shuma prej 250,000.00€, ku duhet të përfshihet edhe mundësia e përkrahjes së punëtorëve shëndetësorë të punësuar në projektin e Karitasit dhe mori:


V E N D I M

1. Për lejimin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 404,000.00€, për vazhdimin e masave parandaluese dhe masave tjera shtesë të nevojshme nga Shtabi Emërgjent i Komunës së Fushë-Kosovës për parandalimin e përhapjes së sëmundjes ngjithëse Coronavirus-it COVID - 19.
2. Shuma e mjeteve financiare prej 154,000.00€ janë mjete financiare të destinuara për shpenzim para alokimit të buxhetit të komunës për vitin 2020, ndërsa shuma tjetër e mjeteve financiare prej 250,000.00€ janë mjete financiare që do të shpenzohen nga

buxheti i komunës i vitit 2020, pas alokimit të buxhetit në funksion të luftës kundër pandemisë së Coronavirusit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 10:30 minuta.

**Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci**



**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**

